

INTERVISTA
FUTBOLLI NE "LUPËN"
E PRESIDENTIT

FAQE 8

INFRASTRUKTURA
STADIUMET, ERË E
RE PËR FUTBOLLIN

FAQE 14

ANTI SPASNJE
HISTORIA NË PESË
PËRBALLJE

FAQE 32



AVENTURA

"BOTËRORE" E KOMBËTARES



SHKODRA, ATJE KU FUTBOLLI ËSHTË FE

Tritan Kokona
Editor i revistës

Kombëtarja është kthyer në Shkodër, për të luajtur eliminatorët e Botërorit “Rusi 2018”. Në fakt, këtij rikthimi nuk mund ti gresh emër më të bukur, se titulli i një kënge të famshme angleze “the soccer come back home” (futbolli kthehet në shtëpi). Po, është e vërtetë, futbollit është kthyer në shtëpi. Atje, ku lindi kjo lojë e mrekullueshme dhe magjike, afro 11 dekada më parë. Shkodra, djepi i futbollit shqiptar, qyteti që u prek i pari nga “epidemia e futbollit”, e cila kishte nisur Angli, për tu përhapur kudo në kontinentin e vjetër. Shkodra ishte e para, e cila priti trokitjen e futbollit, me portën hapur. Qyteti e dashuroi që ditën e parë futbollin, me të njëjtin zjarr e pasion, me të cilin vazhdon ta dojë dhe mbështesë edhe sot. Dikur, në një reportazh mbi festimet në Shkodër për fitoren e titullit kampion, kam zgjedhur një titull: Shkodra, atje ku futbollit është fe. Më pëlqeu që një gjë të tillë ta përsëris edhe sot në numrin e ri të revistës tonë...

Shkodra i gëzohet kombëtares së futbollit. Madje jo vetëm njerës, por të dy skuadrave kombëtare. Të Shqipërisë dhe të Kosovës, e cila

të enjten zhvilloi në stadiumin “Loro Boriçi”, takimin eliminator të Kupës së Botës, kundër Kroacisë. Të dyja këto skuadra të dashura për publikun shqiptar, do të kenë si shtëpi të tyre në këto eliminatorë pikërisht Shkodrën, qytetin ku lindi futbollit. Shkodrën e cila ndër shekuj është shquar për kulturën e saj, për atdhedashurinë dhe intelektualët që i afroi Shqipërisë. Për atë trashëgimi, e cila edhe sot e bën krenare, kryeqendrën e Veriut të Shqipërisë. Pa përmendur emrat e qindra e qindra, artistëve, sportistëve, shkrimtarëve, dramaturgëve, regjisorëve etj. Por futbollit, i cili vazhdon të jetë dashuria e qytetit, e riktheu edhe njëherë vëmendjen e të gjithë shqiptarëve ngado ndodhen, tek Shkodra. Tashmë ajo është shëndruar në një destinacion të rëndësishëm turistik, jo vetëm për shqiptarët por edhe të huajt. Ditët e ndeshjeve apo edhe ato përpara tyre, e gjallërojnë qytetin në një mënyrë festive. Kudo ndjehet atmosfera e harese, gezimit, e ankthit për të arritur rezultatin, e emocioneve të papërshtueshme. E një gjë të tillë, më mirë se kushdo, di ta afrojë mbreti futbollit. Ai me magjinë e tij, i bën njerëzit të përjetojnë çaste të cilat nuk kanë për ti harruar gjatë gjithë jetës së tyre. Çaste, të cilat ruajnë në memorie një pjesë të historisë. Të gjitha këto, që përmenda më lart, në një qytet si Shkodra marrin një kuptim tjetër. Shkodranët, të njohur për humorin e tyre e kanë në gjak mikpritjen për këdo. Jo më kur flitet për dashurinë e tyre të madhe, futbollin, të cilin ata e adhurojnë. Të dyja kombëtares por edhe publiku i gjerë e ka ndër mikpritjen shkodrane. Stadiumi i ri i ka dhënë mundësinë qytetit që të rilindë, të gjallërohet dhe të krijojë miqësi të reja brenda Shqipërisë, Kosovës dhe çdo vendi tjetër. Tashmë Shkodra, shtëpia e dy kombëtareve shqiptare, e ka futur veten në vorbullën e emocioneve që japin eliminatorët, duke bërë gjithçka që atmosfera të jetë sa më e bukur. Për këtë ne e falenderojmë Shkodrën, qytetin ku futbollit lindi në fillimin e shekullit të kaluar. Qytetin ku realisht futbollin e konsiderojnë si një fe.

Përmbajtje



NR. 26, TETOR 2016
Botim zyrtar i Federatës
Shqiptare të Futbollit

**AVENTURA “BOTËRORE” E
KOMBËTARES**
FAQE - 4

**FUTBOLLI, NË LUPËN E
PRESIDENTIT**
FAQE - 8

**STEMA NE KRAH DHE
TABELA TË UNIFIKUARA
PËR KATEGORINË
SUPERIORE**
FAQE - 12

STADIUMET, FRYN NJË ERË

E RE NDRYSHIMESH
FAQE - 14

**BËHU EDHE TI NJË
#HEFORSHE**
FAQE - 19

NEWS
FAQE - 23

**NJE APP(LIKACION) PER
FUTBOLLIN SHQIPTAR**
FAQE - 26

PËRZGJEDHJA E

TALENTEVE
FAQE - 28

**SHQIPËRI – SPANJË,
HISTORIA NË PESË
PËRBALLJE**
FAQE - 32

**ARBITRAT SHQIPTARË NË
KUPAT E EUROPËS**
FAQE - 36

**JO KARTON I KUQ PËR
LOJTARIN E FUNDIT**
FAQE - 38



Armand Duka

PRESIDENT I FEDERATES
SHQIPTARE TE FUTBOLLIT

TË NDERUAR SPORTDASHËS! TË DASHUR MIQ!

Sapo ka nisur edicioni i ri futbolistik, me ndeshjet e Kategorisë Superiore. Është edicioni i 78 i këtij kampionati. Që nga starti i tij i parë në vitin 1930, kampionati i futbollit është bërë gjithnjë e më i dashur dhe i ndjekur në të gjithë qytetet e Shqipërisë. Starti i këtij kampionati, i cili vitet e fundit jo vetëm ka qenë më i bukur por edhe më cilësor, është një ngjarje e rëndësishme për komunitetin e futbollit shqiptar. Prej javësh, futbollistët, stafet teknike, trajnerët, menaxherët dhe drejtuesit e klubeve, po punojnë për të përgatitur sa më mire, këtë fillim të ri. Të gjitha përpjekjet e tyre gjatë kësaj periudhe, kanë patur vetëm një qëllim: Paraqitjen sa më të mirë të skuadrave. Me dëshirën për të ngjitur sa më lart, dhe për të realizuar synimet e tyre. Po kaq e bukur ka nisur edhe Kategoria e Parë dhe ne shpresojmë shumë që kështu do të vazhdojë edhe Kategoria e Dytë që sapo ka startuar këtë fundjavë. Futboli po hyn në dimensionet e tij të zakonshme dhe kjo e bën atë edhe më interesant, në çdo garë, në çdo ndeshje në çdo moment.

Ka nisur një rrugë e gjatë dhe e lodhshme, për arritjen e objektivave që klubet i kanë vënë vetes. Në fakt, është edhe një rrugë e bukur, mbushur me emocione, me ngjarje të paharrueshme të cilat më pas do të regjistrohen në librin e historisë. Çdo klub nis të shkruajë faqen e 78 të historisë së tij prej sot e deri në muajin maj, kur secili do të marrë atë rezultat, që ka merituar në fushën e lojës.

Skuadra jonë kombëtare arriti një fitore shumë të rëndësishme kundër Maqedonisë, në stadiumin e ri "Loro Boriçi" të qytetit të Shkodrës. Kjo fitore, në startin e eliminatorëve të Botërorit "Rusi 2018", ka krijuar shumë entuziazëm në gjirin e tifozëve dhe ka rritur më tepër besimin në skuadër. E gjithë kjo atmosferë pozitive, shpresoj që të transmetohet edhe në fillimin e edicionit të ri

futbolistik. Unë do të uroja që kjo ndeshje të jetë sa më e bukur dhe me rivalitet. Shpresoj shumë, që skuadra të tregojë vlerat e saj të vërteta ndaj një kundërshtari të vështirë, siç është Spanja. Uroj shumë që një përballje e tillë "luksi", të jetë një motiv më shumë që kuqezinjtë, të cilët të tregojnë vlerat e tyre. Uroj shumë që kjo ndeshje të dhurojë spektakël dhe emocion, të cilat do ta ndezin garën dhe do të kënaqin tifozët në shkallët e stadiumit të ri. Fryma e Fair Play, duhet të mbizotërojë në këtë takim, ku të gjithë urojmë që skuadra jonë e zemrës të shprehë më të mirën, përballë një kundërshtari të nivelit të lartë. Të vazhdojmë një rrugë të cilën prej dy vjetësh kemi nisur dhe po e vazhdojmë të sukseshme. Një rrugë e cila i ka bërë të lumtur sportdashësit dhe të gjithë ata që duan futbollin.

Uroj që spektakli dhe kualiteti të shoqërojnë çdo ballafaqim të futbollit shqiptar në të gjitha përballjet e ndeshjet. Mbi të gjitha, do të uroja që ky edicion futbolistik, ku përfshihet jo vetëm kampionati por edhe skuadra kombëtare, të jetë, sa më cilësor nga pikëpamja teknike. Rritja e nivelit të lojës, afirmimi i elementëve të talentuar, janë një garanci që futboli po ecën në rrugën e duhur. Dhe ne po punojmë dhe do të vazhdojmë të punojmë çdo ditë që ai të ecë përpara dhe të tregojë vlerat e tij. Suksese të gjithëve.

Armand DUKA
President i FSHF



AVENTURA “BOTËRORE” E KOMBËTARES

Kuqezinjtë kanë nisur rrugëtimin e radhës, eliminatorët e Botërorit “Rusi 2018”, ku përballë do të kenë emra të mëdha dhe sfida të mëdha. Nisja e mirë ndaj Maqedonisë premton për një tjetër edicion të lavdishëm me strategun Gianni De Biasi në “timonin” e përfaqësueses

NGA FATJON KODRA

Festa e Evropianit ka mbaruar prej kohësh! Kombëtarja shqiptare e futbollit e ka lënë pas krahëve atë sukses historik të pjesëmarrjes në finalët e një Kampionatit Evropian (Francë 2016) për të nisur një tjetër rrugëtim të lavdishëm, po aq të vështirë dhe të mbushur me sfida për kuqezinjtë.

“Do të jetë një grup shumë i vështirë. Nuk do të fshihemi, por do të bëjmë atë që kemi bërë gjithmonë. Do të japim më të mirën nga vetja jonë, pa harruar karakteristikat që treguam në Francë dhe gjatë rrugës së saj. Do të jemi të

përulur, por të bindur për karakteristikat tona. Mundta luajmë fitoren me të gjithë”, do të deklaronte trajneri Gianni De Biasi në konferencën për shtyp ku zbardhi listën e lojtarëve të grumbulluar për dy takimet e radhës. Kualifikimi në finalët e Evropianit ka bërë që pritshmëritë e të gjithëve për përfaqësuesen e futbollit të jenë edhe më të mëdha. Ndonëse jemi në një grup të vështirë dhe të gjithë janë të ndërgjegjshëm për këtë gjë, pritet që kuqezinjtë të bëjnë një paraqitje të mirë në kualifikuese dhe të rivalizojnë deri në fund çdo kundërshtar, qoftë edhe të mëdhatë.

De Biasi vendos të guxojë më shumë duke pozicionuar tre lojtarë në repartin sulmues, por skuadra nuk zbalancohet shumë dhe është po aq e kujdesshme në aspektin mbrojtës.

“Antipasta” e eliminatorëve të Botërorit “Rusi2018” u servir në ditët e fundit të gushtit me një miqësore ndaj Marokut. Një ndeshje që përfundoi 0-0 dhe ku skuadra e drejtuar nga Gianni De Biasi nuk arriti të dominonte plotësisht. Por pesë ditë më vonë Kombëtarja shqiptare ia doli mbanë t’i bënte një start të përkryer, ndonëse të vuajtur, në atë që mund të cilësohet si një ndeshjet më të pazakonta të historisë së kuqezinjve. 90 minutat e këtij takimi u luajtën në harkun kohor të dy ditëve për shkak të reshjeve të mëdha të shiut që pushtuan Shkodrën ato ditë.

Debutimi - Shqipëria u përball me Maqedoninë në ndeshjen e parë të eliminatorëve të Botërorit në Grupi G, ku bëjnë edhe pjesë edhe “pesha të rënda” si Spanja, Italia, por edhe skuadra disi më modeste në letër si Izraeli dhe Lihtenshtejni. Në ndeshjen e parë zyrtare në stadiumin e rikonstruktuar “Loro Boriçi”, tanët do të bënin një start shumë të mirë me De Biasi-n që paraqet në fushë një skuadër me pak ndryshime krahasuar me 11-shin “heroik” të Francës; nuk është më kapiteni Lorik Cana i tërhequr nga Kombëtarja, ndërsa risia është rikthimi i Jahmir Hykës, i cili së bashku me Shkëlzen Gashin mbështesin Armando Sadikun në majën e sulmit. Një vendosje taktike disi më ofensive se zakonisht, duke iu përshtatur edhe kundërshtarit, që në këtë rast ishte pak më i lehtë në letër. De Biasi vendos të guxojë më shumë duke pozicionuar tre lojtarë në repartin sulmues, por skuadra nuk zbalancohet shumë dhe është po aq e kujdesshme në aspektin mbrojtës. Zgjedhjet e teknikut japin menjëherë frytet e veta pas vetëm 9 minutash lojë. Është gjithnjë ai, Sadiku, i cili pasi zotëron bukur një top në hyrje të zonës godet saktë për të mundur portierin maqedonas, Kostadin Zahov. Pak pas fillimit të pjesë së dytë (51’), Aliksi barazon shifrat pas një gabimi të lojtarëve tanë, ndërkohë që minutën e 77-të gjyqtari turk Hüseyin Göçek vendosi të ndërpresë sfidën për shkak të shiut. Pjesa e mbetur e ndeshjes do të luhej më 6 shtator duke filluar nga ora 14:00, teksa kronometri rinisi nga minuta e 76-të. Të hedhur në fushë gjatë pjesë së dytë, Memushaj e Balaj do të bëheshin protagonistët kryesorë të kësaj ndeshjeje, teksa ishin ata që “gatuan” edhe goditjen përfundimtare. Krosimi i saktë i mesfushorit në minutën e 89-të nga goditja e dënimit gjeti kokën e sulmuesit, i cili shënoi dhe fiksoi rezultatin në shifrat 2-1. As tre minutat shtesë të akorduara nga gjyqtari nuk ndryshojnë situatën. Përfundon me kaq teksa Shqipëria e futbollit e nis si mos më mirë aventurën e Botërorit 2018.



“Nuk ishte e vështirë ta motivoja skuadrën sepse vinim nga një pjesë e parë e mirë dhe pjesa e dytë ku nuk dolëm në lojën tonë dhe ramë në kurthin e tyre. Për fat të mirë gjetëm këtë gol. Unë shpresoja që të rigjenim golin me goditje standarde. Kjo fitore na lumturon sepse jemi në kuotën e 3 pikëve si Spanja dhe Italia”, - do të deklaronte De Biasi pas ndeshjes me Maqedoninë.

“Kemi lojtare të aftë për të luajtur edhe nga krahët me Agollin e Lenjanin dhe Hysajn e Roshin. Mund të luajmë me çdo modul që duam, por skuadra duhet t’i interpretojë në mënyrën më të mirë. Ne duhet të mësojmë të përshtatemi gjatë ndeshjes sepse Maqedonia luajti këtu me 5 mbrojtës”.

Situata e grupit - Me 3 pikë pas një ndeshjeje, po aq sa edhe Spanja e Italia, dy mes pretendenteve kryesore të Grupit G, që po më 5 shtator fiksuan fitoret respektive. Spanjollët e drejtuar tashmë nga Lopetegui shkatërruan Lihtenshtejnin me rezultatin 8-0 në takimin e luajtur në “Estadio Reino de León”. Spikatën Diego Costa, Alvaro Morata dhe David Silva, të cilët shënuan nga një dopietë secili. Në tabelën e golshënuesve shkruan emrat edhe Sergio Roberto dhe Vitolo.

Sakaq, në ndeshjen tjetër të grupit, Italia doli me 3 pikë të plota nga “Sammy Ofer Stadium” i Haifa-s pasi mundi me

Gjithmonë më e mira



www.birrapeja.com


BIRRA
PEJA

rezultatit 1-3 vendasit e Izraelit. Pelle (14') e më pas Candreva (me penallti në të 31-n) kaluan në avantazh të dyfishtë "azzurr"-ët, por Ben Haim ngushtoi shifrat 4 minuta më pas. Të mbetur me 10 lojtarë pas daljes me karton të kuq të Chiellini-t, skuadra e Giampiero Ventura-s vuajti derisa në minutën e 83-të arriti të gjente golin e sigurisë, që erdhi nga këmbët e Immobile-s.

Këto ishin verdiktet e "raundit të parë" në pritje të përballeve të dyta në këto eliminatorë. Kombëtarja shqiptare ka shansin më të mirë për të marrë pikë të plota pas dy takimeve të para kur të përballet me Lihtenshtejnin në transfertë, takim që do të luhet mbrëmjen e 6 tetorit në stadiumin "Rheinpark" të Vaduzit. Praktikisht, bëhet fjalë për kundërshtarin më të dobët të grupit tonë. Po më 6 tetor do të luhet dueli që do të tërheqë ndoshta vëmendjen e gjithë Evropës. Në "Juventus Stadium" të Torinos do të përplasim brirët Italia dhe Spanja. Një takim që mund të vendosë shumë për fatet e kualifikimit. Ndërsa, takimi i tretë i mbrëmjes për Grupin G do të jetë ai Maqedoni-Izrael, që luhet në stadiumin "Philip II Arena" të Shkupit. Pas këtyre 90 minutave do të kemi një ide më të qartë për forcën e secilës prej 6 skuadrave që janë në Grupin G. Presidenti i FSHF-së, Armand Duka ka refuzuar të bëjë parashikime për eliminatorët e Botërorit të 2018-s, por ai është i bindur në diçka.

"Ne ndoshta mund të kemi pikë të sigurta, por asnjë tripikësh të sigurt për ta fituar dhe asnjë tripikësh të sigurt për ta humbur", u shpreh numri 1 i FSHF-së disa ditë më parë në një intervistë televizive.

Zgjedhjet – Trajneri Gianni De Biasi vazhdon t'i mbetet besnik filozofisë së tij të lojës, pikërisht saj filozofie që e Shqipërinë deri në finalët e "Francë 2016". Strategu kuqezi nuk ka ndryshuar thujtë asgjë krahasuar me Evropianin: skemat janë të njëjtat, edhe lojtarët po ashtu. Siç e theksuam edhe më parë, ndryshimet janë shumë të vogla, ndonëse është e qartë se De Biasi po tregohet selektiv për të tërhequr në Kombëtaren A talentet më të mira apo lojtarët që janë në formën e tyre më të mirë. Kështu ndodhi me Jahmir Hykën, i cili pasi shkëlqeu me paraqitjet e tij në startin e sezonit me FC Luzern-ën në Zvicër, mori menjëherë ftesën për t'u grumbulluar me Kombëtaren. Mes prurjeve të reja janë edhe Thomas Strakosha dhe Rey Manaj, dy lojtarë të spikatur me ekipet kombëtare të moshave, të cilët po kalojnë një moment të mirë. Strakosha është bërë tashmë portieri i dytë i Lazio-s, madje bëri edhe debutimin e tij në Serie A, ndërsa Manaj është bërë menjëherë protagonist në radhët e Pescara-s po në kampionatin elitare të Italisë duke shënuar edhe gola me peshë. Lajmi i mirë është se thujtë të gjithë lojtarët janë stabilizuar në skuadrat e tyre dhe janë në pozita edhe më të mira, duke luajtur vazhdimisht në formacion.



Objektivat - Kur flitet për objektiva, stafi teknik i Kombëtares qëndron me këmbë në tokë, i vetëdijshëm se nuk do të jetë e lehtë të përsëritet Evropiani, por nuk pranohet kurrsesi që të përjashtohen surpriza dhe të luftohet deri në fund për kualifikimin.

Berat Gjimeshi gjatë një dyluftimi në ndeshjen kundër Maqedonisë ku Shqipëria fitoi me rezultatin 2-1

"Nevojitet të përqendrohemi te realiteti i ri dhe të harrojmë atë që ndodhi në Evropian. Edhe për të shkuar në Francë ishte e vështirë, por ia dolëm me bindje, këmbëngulje dhe forcën e grupit. Në kualifikueset e Botërorit duhet të bëjmë më të mirën e mundshme. Federata më kërkon të japim maksimumin dhe atë që bëjmë zakonisht", - do të deklaronte trajneri Gianni De Biasi në startin e përgatitjeve për eliminatorët e Botërorit "Rusi 2018". Dhe në të vërtetë, kuqezinjtë nuk mund të shohin larg, por duhet të fokusohen te sfida e radhës, ajo ndaj Lihtenshtejnit në transfertë. Një ndeshje delikate duke qenë se përballemi me një kundërshtar modest, nga ato që nëse i nënvlerëson mund të gabosh rëndë, pasi përballësh me surpriza të pakëndshme. Janë nga ato sfidat ku motivimi nuk është shumë i madh sepse përballë nuk ke lojtarë me famë botërore, por lojtarë modest dhe të panjohur. Dhe stafi teknik kuqezi këtë e di shumë mirë, ndaj duhet ta përgatisë sa më mirë këtë duel, ashtu si edhe atë që vjen tre ditë më pas, Spanjën e madhe. Gjashtë pikë në dy ndeshjet e para do të ishte një hap i rëndësishëm në këto eliminatorë. Përgatitjet kanë nisur, fokusi është i gjithë në ndeshjet e tetorit.

FUTBOLLI, NË LUPËN E PRESIDENTIT

Presidenti i FShF-së, Armand Duka analizon zhvillimet më të fundit të futbollit shqiptar dhe analizon ecurinë e Kombëtares në eliminoret e Botërorit “Rusi 2018”. Flet edhe për tërheqjen e kapitenit Lorik Cana nga përfaqësuesja dhe komenton punën e bërë nga trajneri Gianni De Biasi në stolin kuqezi



Edicioni i ri i eliminoreve të Botërorit 2018 po hyn në fazën më të nxehtë, ndërsa Kombëtarja shqiptare i ka bërë një start të mirë pas asaj fitoreje ndaj Maqedonisë në ndeshjen hapëse. Një duel që u luajt në stadiumin “Loro Boriçi” të rikonstruktuar, që i shtohet listës së impianteve moderne që po pasurojnë infrastrukturën e futbollit shqiptar kohët e fundit. Sakaq, edhe kampionati shqiptar ka nisur vlu-

lshëm në një edicion që premtonte shumë emocione, duke parë atë që kanë dhënë skuadrat në fushë gjatë këtyre javëve të para. Në një intervistë të dhënë për revistën, Presidenti i FShF-së, Armand Duka, analizon në detaje zhvillimet më të fundit të futbollit shqiptar, duke vlerësuar risitë, anët pozitive, por edhe problematikat me të cilat përballemi. Presidenti e nis që nga kampionati shqiptar për të vazhduar më tej me problematikat që janë hasur në kategoritë inferiore me licencimin apo dhe shlyerjen e detyrimeve nga klubet. Gjithashtu, z. Duka flet për stadiumin e ri të Shkodrës, ku gjen rastin të falënderoj Kryeministrin Rama për vëmendjen e vazhdueshme që ka treguar në drejtim të futbollit me investime të rëndësishme.

Më tej, Presidenti Duka skanon edhe grupin eliminator të Botërorit “Rusi 2018”, ku bën pjesë edhe Shqipëria, teksa analizon rivalët e tjerë dhe synimet që ka Kombëtarja shqiptare. Ndër të tjera, z. Duka komenton tërheqjen e kapitenit Lorik Cana nga Kombëtarja si edhe vlerëson punën e bërë nga trajneri Gianni De Biasi dhe stafi i tij në drejtimin e skuadrës kuqezi. Duke i hedhur një sy arritjeve të përfaqësueses shqiptare, Presidenti i FShF-së cilëson si momentin kulmant pjesëmarrjen e Shqipërisë në finalët e Evropianit “Francë 2016”, duke e përkufizuar si një eksperiencë të jashtëzakonshme dhe të paharrueshme.

Sapo ka nisur një edicion i ri futbollistik. Cili



do të ishte komenti i Presidentit të FSHF, në lidhje me këtë start të ri?

Javët e para të Kategorisë Superiore, në përgjithësi kanë dhuruar spektakël dhe lojë të mirë. Sigurisht, jo të gjitha skuadrat janë të kolauduara dhe në kulmin e formës por kjo është normale në çdo fillim kampionati. Vërej një dëshirë të skuadrave për të bërë paraqitje sa më të mira. Natyrisht, mund të gjesh edhe mangësi, një prej të cilave ka lidhje me forcën goditëse ose konkludimin përpara portës, e cila nuk ka qenë në nivelin më të lartë. Po marr për shembull ndeshjet e javës së 4-t të kampionatit, ku është shënuar vetëm një gol në pesë ndeshje. Mendoj, se kjo nuk ka lidhje vetëm me paaftësinë apo me zhbllokimin e sulmuesve. Natyrisht, të krijosh dhe të sulmosh portën e kundërshtarit, është shumë më e vështirë se sa të mbrohesh dhe qarkullosh topin për të arritur një barazim. Këtë trajnerët e dinë mirë. Mendoj se me kalimin e javëve dhe me ndezjen e luftës sportive, edhe këto mangësi që vihen re përpara portës, do të vijnë duke u përmirësuar.

Ndërkohë ka patur probleme me kategorinë e parë dhe të dytë, kampionatet e të cilave u shtynë për një farë kohe. Cilat ishin ato?

Ka patur probleme me plotësimin e dokumentacionit dhe kriteret e licencimit, si edhe me shlyerjen e detyrimeve financiare nga ana e disa

klubeve të kategorisë së parë dhe të dytë. Për këtë arsye, ne menduam që ti japim kohë klubeve për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm dhe për të shlyer detyrimet. Që në fillim të sezonit përgatitor, Federata Shqiptare e Futbollit është përpjekur që ti ndërgjegjësojë klubet në lidhje me plotësimin e kriterëve të licencimit. Ajo që Federata Shqiptare e Futbollit si institucion kërkon nga klubet, është bashkëpunimi për të plotësuar sa më mirë ato. Dhe këtu nuk bëhet fjalë, thjesht për të plotësuar disa dokumenta. FSHF, ka si qëllim të

Megjithatë, ne kemi treguar edhe herë të tjera, që kur luajmë mirë me të gjithë kapacitetet tona, i vëmë në vështirësi edhe të mëdhenjtë

”

saj strategjik, formalizimin jo vetëm të klubeve por të gjithë futbollit shqiptar. Kjo është arsyeja, për të cilën ne kemi këmbëngulur dhe do të vazhdojmë të këmbëngulim fort, në këtë drejtim.

Stadiumi i Shkodrës, ka qenë një tjetër impenjim i institucionit dhe juaji, gjatë kësaj periudhe. Si ndjeheni, tani që punimet kanë përfunduar?



Sigurisht, që është një impiant madhështor nga pikëpamja e ndërtimit dhe një tjetër stadium, që plotëson të gjitha kriteret për të zhvilluar takime të rëndësishme ndërkombëtare. Pas “Elbasan Arena”, një tjetër stadium modern i afrohet publikut dhe sportistëve shqiptarë. Duhet të falënderoj Qeverinë Shqiptare për këtë investim, të kryer në bashkëpunim edhe me FShF. Por jo vetëm për stadiumin e Shkodrës apo për stadiumin kombëtar në Tiranë, i cili ka nisur të hedhë themelet. Më duhet të falënderoj publikisht Kryeministrin Edi Rama, për faktin se gjatë gjithë kësaj periudhe i ka qëndruar pranë futbollit dhe është përpjekur personalisht, që ky sport të ecë përpara në rrugën e suksesit.

Kombëtarja ka zhvilluar ndeshjen e parë me Maqedoninë. Cilat ishin përshtypjet tuaja për këtë takim?

Ishte një ndeshje e vështirë. Nisëm gjithçka mirë dhe kishim në dorë që pas avantazhit ta kontrollonim ndeshjen dhe ta godisnim përsëri kundërshtarin. Për fat të keq, ritmi i lojës, në pjesën e dytë ra ndjeshëm dhe skuadra sikur u përgjum. Pësimi i golit të barazimit, realisht na vuri në vështirësi. Ekipi duhet ta vlerësonte më shumë kundërshtarin. Skuadra si Maqedonia, Izraeli dhe Lihtenshtejni janë realisht rivalët tona në grup. Ne jemi të detyruar që në çdo ndeshje të japim mbi 100 përqind të kapaciteteve tona. Përndryshe, do ta kemi të vështirë. Skuadra, besoj se ka

nxjerrë mësim nga ajo që ndodhi me Maqedoninë. Ne luftuam shumë të nesërmen në ato 15 minuta të mbetura. Por nuk kemi përse të vuajmë kështu, sidomos kur arritëm të shënojmë dhe kishim mundësi ta kontrollonim qetësisht lojën. Sidoqoftë, do ta konsideroja një fillim të mbarë dhe një rezultat tepër të rëndësishëm.

Flasim pak për grupin eliminitor. Cili është komenti i Presidentit të FShF në lidhje me rivalët?

Pa qenë nevoja të përsëris, mendoj se është një grup shumë i fortë. Është e vërtetë që skuadra është rritur dhe duket më e pjekur. Është gjithashtu e vërtetë, se për shkak të rezultateve të mira të arritura në dy vitet e fundit, kërkesa dhe pretendimet ndaj saj, janë rritur shumë. Realisht mendoj se po të japim maksimumin dhe të evitojmë disa gabime, do të vazhdojmë të jemi një surprizë e këndshme e këtyre eliminatorëve. Ne duhet të përqendrohemi shumë, për të mos toleruar kundër kundërshtarëve tanë direktë, si Izraeli, Maqedoni dhe Lihtenshtejni. Sa i takon Spanjës dhe Italisë, është e tepërt të kujtoj se po flasim për dy ndër shkollat më të mëdha të futbollit, të lauruara me suksese si europiane ashtu edhe botërore. Megjithatë, ne kemi treguar edhe herë të tjera, që kur luajmë mirë me të gjithë kapacitetet tona, i vëmë në vështirësi edhe të mëdhenjtë. Madje më shumë se kaq. Edicionin e kaluar ne e kemi treguar këtë përballë skuadrave të

mëdha si Portugalia dhe Franca. Pa folur pastaj për finalet e Europeanit. E gjithë kjo rrugë e ka forcuar skuadrën, ka rritur besimin tek djemtë dhe është një eksperiencë, e cila do të shërbejë shumë për të ardhmen. Për më tepër që skuadra nuk është nën presion dhe karikimi i futbollistëve përballë yjeve të futbollit botëror do të jetë në shkallën më të lartë. Në futboll diferencat janë ulur. Për ne e rëndësishme është që të japim maksimumin dhe të gabojmë sa më pak.

Është larguar kapiteni Cana pasi e ka veshur 94 herë uniformën e skuadrës kombëtare. Si do ta komentoni largimin e tij?

Si largimin e një futbollisti, kapiteni dhe njeriu të madh. Vlerësoj maksimalisht kontributin e tij si lojtar dhe personalitet gjatë gjithë viteve që ai ka qenë pjesë e kombëtares së Shqipërisë. Sigurisht, të vjen keq që largohet një personalitet i tillë por zgjedhjet janë personale dhe futbollit i tillë është. Mendoj se Loriku, do të vazhdojë të qëndrojë në futboll. Ai po përfundon kursin “UEFA B”, për marrjen e licencës së trajnerit dhe besoj se ka ende shumë për të dhënë këtij sporti, nga eksperienca e një karriere të shkëlqyer, që ka arritur.

Si do ta vlerësonit punën e deritanishme të trajnerit De Biasi?

Të shkëlqyer. Një punë serioze e një njeriu të përkushtuar dhe e një profesionisti të vërtetë. Ai drejton një staf të mbushur me profesionistë, ka krijuar një ambient mjaft të mirë në skuadër dhe ka përzgjedhur një grup futbollistësh, të cilët janë vërtetë shumë të përkushtuar. Jam shumë i kënaqur nga puna e tij dhe i lumtur për zgjedhjen që kemi bërë. Unë besoj tek aftësitë e trajnerit, tek stafi profesional që ai ka përzgjedhur e punon me të, si dhe jam i kënaqur me rezultatet e deritanishme.

Gjatë kësaj periudhe, ka patur edhe aktivitete të tjera të skuadrave kombëtare në nivele moshash?

Po, është zhvilluar në muajin shtator në Tiranë dhe në Durrës, Turneu Eliminator i Kampionatit European (Grupi i katërt) për kategorinë U-19 femra. Një organizim që kërkon shumë punë dhe impenjim nga ana organizative. Skuadra jonë megjithëse me një eksperiencë minimale arriti të fitojë një ndeshje, e cila është edhe fitorja e

parë zyrtare e kësaj skuadre që ka shumë pak vite që është krijuar. Natyrisht na duhet të punojmë më tepër, në mënyrë që të ballafaqohemi sa më denjësisht në aktivitetet e tjera. Po kështu, këto ditë ka nisur edhe aktiviteti tjetër european. Bëhet fjalë për Turneu Eliminator të Kampionatit European për kategorinë U-19 djem. Ndeshjet po luhen përsëri në Tiranë dhe Durrës dhe ne kemi punuar që gjithçka të shkojë sa më mirë sa i takon organizimit. Në këtë drejtim ne kemi fituar një eksperiencë mjaft të mirë pasi është e disata herë që kemi marrë përsipër zhvillimin në Shqipëri të aktiviteteve të tilla të rëndësishme. Ne jemi në të njëjtin grup me Gjermaninë, Republikën e Irlandës dhe Gjibraltarin, në këto eliminatore.

Gjatë kësaj periudhe të mbushura me ngjarje të njëpasnjëshme, cilën do të veçonit më tepër?

Padyshim periudhën pas kualifikimit për në finalet e Kampionatit European dhe sidomos gjatë kohës së finaleve në Francë. Ishte diçka e jashtëzakonshme. Një emocion i papërshtatshëm dhe mendoj se jo vetëm për mua por për të gjithë shqiptarët. Kjo jo më kot, është quajtur realizimi i një ëndrrë të kahershme të futbollit shqiptar. Momentet e Europeanit, do të mbeten gjatë në kujtesën time. Shpesh i kthehem atyre ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe atyre emocioneve të papërshtatshme, të cilat na shoqëruan gjatë atyre ditëve të mëdha për futbollin shqiptar. Përpara se të niseshim për në Francë, i kam thënë djemve dhe stafit, që ta shijojnë sa më shumë gjithçka. Këtë e kam thënë sinqerisht dhe jo thjesht për të mos i ngarkuar psikologjikisht djemtë, të cilët shkonin në një kompeticion të rëndësishëm për herë të parë. Por se realisht një ngjarje e tillë, ishte një eksperiencë e jashtëzakonshme dhe e paharrueshme. Performanca e skuadrës, e stafit, e vetë FSHF, emocionet e lojës dhe në mënyrë të veçantë paraqitja e shkëlqyer dhe qytetare e tifozërisë tonë, kanë qenë të gjitha ngjarje të paharruara. I kujtoj shpesh ato ditë, që kanë mbetur të pashlyera në kujtesën time dhe tashmë kanë hyrë në librin e historisë së futbollit shqiptar, për të shkruar faqe nga më të suksesshmet. Ende ndjehem keq, që nuk patëm mundësi që të kalonim turin sepse realisht meritonim më shumë dhe skuadra kishte ende për të dhënë në këtë eksperiencë të parë të saj. Gjithsesi tani duhet të shohim përpara drejt sfidave dhe objektivave të reja.

Sigurisht, që vjen keq që largohet një personalitet i tillë por zgjedhjet janë personale dhe futbollit i tillë është. Mendoj se Loriku, do të vazhdojë të qëndrojë në futboll





STEMA NE KRAH DHE TABELA TË UNIFIKUARA PËR KATEGORINË SUPERIORE

Kampionati kombëtar i Kategorisë Superiore, do të ketë edhe njërisi krejtësisht të veçantë në edicionin e sivjetëm. Sektori i Garave, në Federatën Shqiptare të Futbollit, ka menduar që gjatëndeshjeve të këtij kampionati, të përdoren tabela të reja elektronike,

për ndërrimet e futbollistëve dhe akordimin e minutave shtesë. Për herë të parë në Shqipëri, këto tabela do të jenë të unifikuara në pesë ndeshjet e Kategorisë Superiore. Tabelat elektronike, do të fillojnë të përdoren në ndeshjet e javës së tretë dhe në vazhdim. Sipas shefit



Ndeshje të kampionatit kombëtar të Kategorisë Superiore ku shquhet logo e personalizuar

përmirësimin e imazhit global të futbollit shqiptar.

Kategoria Superiore dhe Kupa e Shqipërisë në këtë fillim të sezonit futbollistik 2015-2016, do të kenë një brand të ri, që do të jetë elementi themelor i imazhit të këtyre kompeticioneve.

Ky lançim do të pasohet nga një implementim i centralizuar me elementë të pozicionuar në çdo stadium dhe do të ketë gjithashtu edhe elemente grafike televizive, një spot zyrtar, një logo nëmëngët e bluzave të skuadrave të Superiores, etj.

“Në bashkëpunim edhe me sektorin e marketingut edhe në sezonin e kaluar ne kemi krijuar logon e Kategorisë Superiore dhe logon e Kupës së Shqipërisë, një risi që do të shoqërohet këtë vit edhe me vendosjen e logove në fanellat e skuadrave për të personalizuar Kategorinë Superiore. Në të gjitha ndeshjet e kampionatit lojtarët do të kenë në mëngët e fanellave logon e kampionatit, madje edhe në fotot zyrtare apo emisione, çka tregon se kjo kategori do të arrijë një tjetër nivel edhe në rangun e brandimit”, shpjegon Shefi i Sektorit të Garave, Nurishmi.

Ky është hapi i parë i një marketingu të centralizuar, që është prezantuar paraprakisht edhe shumë bizneseve që operojnë në tregun shqiptar. Me këtë nismë të ri hidhen bazat për një marketing bashkëkohor, që të jetë edhe më atraktiv për bizneset që do të duan të mbështesin dhe të bashkëpunojnë me futbollin shqiptar.

I gjithë procesi ka kaluar në disa faza ndër të cilat më e rëndësishmja ka qenë ajo e konsultimeve me grupimet e interesit si klubet, profesionistë nga bota e medias, menaxhimit, si dhe një numër jo i vogël kompanish operuese në vendin tonë. Këto risi do të ndihmojnë për t'i dhënë një tjetër imazh kampionatit shqiptar dhe për t'u përafëruar akoma me shumë me standardet e ligave elitare evropiane.

të Sektorit të Garave, Lysien Nurishmi: “Tabelat do të jenë të personalizuara me logon e aktivitetit, pra me atë të Kategorisë Superiore”. Kjo është një tjetër risi, e cila e synon që të krijojë një linjë të personalizuar për këtë aktivitet.

Më herët Sektori i Garave, ka vendosur që në fanellat e futbollistëve që aktivizohen në këtë kampionat të vendoset logo e Kategorisë Superiore. Ky proces vjen si një vazhdim inatyrshëm i një plani më të madh, i cili filloi me “rebrand”-imin e Federatës Shqiptare të Futbollit dhe ka për objektiva ripozicionimin dhe

Ky është hapi i parë i një marketingu të centralizuar, që është prezantuar bizneseve shqiptare

Nga “Loro Boriçi” e deri te “Arena Kombëtare” që është në ndërtim e sipër: si kanë ndryshuar stadiumet shqiptare dhe investimet e rëndësishme që po zhvillohen në të gjitha impiantet e qyteteve kryesore të vendit

NGA FATJON KODRA



STADIUMET, FRYN NJË E

Infrastruktura e futbollit shqiptar, dikur një gangrenë e vërtetë, ka njohur zhvillime të rëndësishme gjatë viteve të fundit. Federata Shqiptare e Futbollit me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, por edhe klubet kanë bërë investime të mëdha duke i dhënë kësaj futbollit një hop cilësor të ndjeshëm. Dëshmia më e fundit e këtyre ndryshimeve është pikërisht “Loro Boriçi” i Shkodrës, i rikonstruktuar totalisht me një kosto prej rreth 2.2 miliardë lekësh dhe i inauguruar me ndeshjen miqësore të 31 gushtit mes Shqipërisë dhe Marokut.

“Loro Boriçi” - Impianti shkodran do të mirëpresë edhe ndeshjet Kombëtares Shqiptare në kompeticionet europiane e botërore dhe ofron kushte bashkëkohore duke u kthyer në stadiumin më të mirë në Shqipëri.

“Loro Boriçi” tashmë ka një kapacitet mbi 16 mijë vende dhe shumë shpejt do të pajiset me një pistë atletike e standardeve olimpike me 8 korsi. Gjithashtu, stadiumi ka ambiente për mjekët dhe anti-dopingun dhe hyrja e sportdashësve është e automatizuar. Nën shkallët e tij ka ambiente për stërvitje të disiplinave të tjera sportive, si atletika, mundja, boksi, ping-pongu etj.

Sipas ambienteve është një stadium i nivelit 5, por është kapaciteti ai që e ndan, pasi këto lloj stadiumesh duhet të kenë mbi 30.000 spektatorë. Në këtë stadium mund të zhvillohen të tëra aktivitetet e Champions League. Me një tapet me cilësi mbresëlënëse, ajo që bie në sy nga fusha janë daljet e shumta të emergjencës, për sigurinë maksimale të tifozëve. Prej kohësh, “Loro



ERË E RE NDRYSHIMESH

Boriçi” kishte degraduar dhe ishte vënë në vështirësi funksionimi e tij si një arenë sportive, për të mos folur për përmbushjen e standardeve europiane. Tashmë është një stadium modern dhe një vlerë e shtuar për futbollin shqiptar.

“Elbasan Arena” - I dyti për nga radha, por po aq i rëndësishëm, është “Elbasan Arena”, i rikonstruktuar gjithashtu totalisht dhe i inauguruar në tetor të vitit 2014 në ndeshjen ndaj Danimarkës, e vlefshme për eliminatorët e Evropianit “Francë 2016”. Stadiumi ka një kapacitet rreth 12.500 vendesh dhe ndryshoi krejtësisht fytyrë falë një investimi të përbashkët mes Qeverisë Shqiptare dhe Federatës Shqiptare të Futbollit me vlerë 5.5 milionë euro. Do të bëhej asokohe im-

pianti i parë në Shqipëri me standardet e një stadiumi ndërkombëtar të FIFA-s dhe që ofron infrastrukturën më komode të mundshme për skuadrat, tifozt, por edhe median. Gjatë dy viteve të fundit ky stadium ka mirëpritur ndeshjet e skuadrave shqiptare si Skënderbeu, Kukësi apo dhe Partizani në fazën eliminatorë të Champions League dhe Europa League. Madje, pas kualifikimit historik në fazën e grupeve të Europa League, Skënderbeu i ka luajtur të gjitha ndeshjet brenda pikërisht në Elbasan, pasi ishte i vetmi impiant që plotësonte kushtet e kërkuara.

“Arena Kombëtare” - Ndërkaq, shumë shpejt futbollit shqiptar do të ketë edhe stadiumin më të mirë dhe mbase më të mirin në rajon, pasi puna ka nisur. Stadi-



Për t'u ndjerë çdo ditë në formë

Uji i Skadrës
Kombëtare
Shqiptare
të Futbollit



Nr. 1 në Cilësi



umi kombëtar “Qemal Stafa” u rrafshua pak kohë më parë për të ndërtuar po në atë vend atë që do të quhet “Arena Kombëtare”. Projekti i stadiumit të ri “Arena Kombëtare” parashikon një kapacitet prej 22.000 vendësh dhe me të gjitha tribunat e mbuluara. Godina do të përmbajë rreth 14.000 metra katrorë qendër biznesi dhe facilitete të tjera, ndërsa 4000 metra katrorë do të jetë një sipërfaqe në dispozicion të Federatës Shqiptare të Futbollit.

I projektuar si një strukturë e integruar dhe i klasifikuar në Kategorinë 4 sipas përcaktimeve të UEFA-s mbi stadiumet, ky kompleks i ri do të shndërrohet edhe në një element apo qendër të re sociale të Tiranës, teksa do të shfrytëzohet dhe përdoret si një godinë publike dhe në përdorim gjatë të gjithë vitit.

Stadiumi kombëtar i Shqipërisë është parashikuar të jetë gati në vitin 2018 dhe është vlerësuar se ka një kosto rreth 50 milionë euro. Ky impiant do të ndërtohet përmes një skeme partneriteti publik-privat.

“Selman Stërmasi” - Një tjetër stadium që i është nënshtruar një ndryshimi thuajse rrënjësor është edhe “Selman Stërmasi” i kryeqytetit. Impianti i nënshtrua brenda një kohe të shkurtër rikonstruksionit të plotë, që ka tjetërsuar këtë stadium. Klubi i Tiranës që është edhe investitori, ka ndërhyrë në ambientet e brendshme, duke krijuar kushte komode për skuadrat dhe zyrtarët, ndërkohë që është tribuna janë rinovuar së bashku me fushën si edhe ka të instaluar tashmë një impiant ndriçimi që mundëson luajtjen e ndeshjeve edhe gjatë mbrëmjeve. Stadiumi ka një kapacitet 9600 vendesh, sektorë të veçantë për tifozërinë mike, sektorë për personalitetet, ndarje të veçantë për gazetarët, zona miqs, tualete, një barkafë në tribunën qendrore dhe një tjetër në tribunën përballë, nëntë hyrje, zona të dedikuara për transmetimin televiziv, parking të dedikuar dhe shumë detaje të tjera, që plotësojnë standardet e nevojshme për një stadium bashkëkohor, të licencuar nga UEFA për zhvillimin e ndeshjeve.

Stadiumet e tjera- Falë edhe këmbënguljes së Federatës Shqiptare të Futbollit nëpërmjet sektorit të licencimeve ky sezon do t'i gjejë shumë nga stadiumet e skuadrave të Kategorisë Superiore me fusha të reja dhe impiante më të mira, çka në mënyrë të pashmangshme do të ndikojë edhe në rritjen e cilësisë së lojës. Pak kohë më parë, klubi i Laçit ka ndërruar tapetin e stadiumit, teksa investime të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës janë bërë dhe po bëhen edhe në stadiumet e Vlorës, Korçës, Durrësit, Gjirokastrës, Dibërës, etj. Forcimi i kushteve për licencimin e skuadrave veçanërisht në Kategorinë Superiore ka shtyrë klubet që të investojnë në impiantet përkatëse. Për të mos harruar edhe Partizanin, që ka nisur ndërtimet për kompleksin e ri të klubit në periferi të Tiranës, ku



I projektuar si një strukturë e integruar dhe i klasifikuar në Kategorinë 4, ky kompleks i ri do të shndërrohet edhe në një element apo qendër të re sociale të Tiranës



parashikohet edhe një stadium që do të presë ndeshjet e skuadrës kryeqytetase.

Me pak fjalë, këto ndryshime të dukshme në infrastrukturë pritet që të sjellin edhe rritje të cilësisë së lojës, kampionatit shqiptar, të afrojnë edhe më shumë tifozët me stadiumet, duke i dhënë shkëlqimin e duhur futbollit shqiptar. E ardhmja premtan shumë.


Aplikacioni Tifozi #HeForShe

Luaj, fito dhe angazhohu për një shoqëri të barabartë

HeForShe në STADIUM

HeForShe në Stadium, është një iniciativë e UN Women në partneritet me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe me mbështetjen e Fondacionit "Vodafone", duke u shtrirë në 10 ndeshje të superligës, në 9 qytete të Shqipërisë gjatë periudhës Tetor - Dhjetor.

"HeForShe në Stadium", do të përfshijë informimin dhe ndërgjegjësimin e tifozëve brenda e jashtë stadioneve të përzgjedhura. Ndaj u krijua Aplikacioni "Tifozi HeForShe", ku tifozët mund të ndërveprojnë në kohë reale duke ndarë mesazhe sensibilizuese, luajtur me lojën "Fanella e Zembrës", si dhe marrë pjesë në QUIZ-in brenda / jashtë stadiumit.



Aplikacioni "Tifozi HeForShe"

"Tifozi HeForShe" është një Aplikacion për telefona 'Android'. E konceptuar si platformë komunikimi, argëtimi dhe ndërveprimi "Tifozi HeForShe" do të bashkojë të gjithë fansat e futbollit shqiptar duke:

- ▶ luajtur e fituar çdo javë telefona të teknologjisë së fundit nga Vodafone, në Quiz-in "OFFLINE" dhe "LIVE".
- ▶ u argëtuar me lojën "Uniforma e Zembrës"
- ▶ ndarë me miqtë dhe publikun e gjerë foto/mesazhe apo angazhimin tuaj në mbështetje të #HeForShe

3 Hapat e thjeshtë të përdorimit



1



Shkarko aplikacionin.
Bëj kërkimin nga Android Store duke shkruajtur *Tifozi #HeForShe*.

2



Bëj regjistrimin
Regjistrohu përmes llogarisë së Facebook ose Google (informacioni mbetet konfidencial).

3



Zotohu / Angazhohu
Posto një foto ose një mesazh apo zotohu në faqen www.heforshe.org



HeForShe

Vodafone
Albania
Foundation



NDRYSHO PERSPEKTIVAT: BËHU EDHE TI NJË

#HEFORSHE

Aplikacioni “Tifozi #HeForShe”:
Luaj, fito dhe angazhohu për një
shoqëri të barabartë

PËRSE #HEFORSHE?

Axhenda e lëvizjes globale/kombëtare për barazisë gjinore është drejtuar kryesisht nga gratë. Por, angazhimi i djemve dhe burrave – gjysmës tjetër të njerëzimit – është themelor për t’i dhënë zhvillim barazisë gjinore.

Ndaj u krijua #HeForShe, kjo lëvizjeje solidariteti mes burrave e grave për të arritur barazinë gjinore.

LEVIZJA #HEFORSHE

“HeForShe” është një Lëvizje Solidariteti për Barazinë Gjinore e Organizatës së Kombeve të Bashkuara - UN Women, përmes së cilës burrat e djemtë nga e gjithë bota flasin hapur, angazhohen dhe veprojnë konkretisht rreth çështjeve të pabarazisë me të cilat përballen sot gratë e vajzat.

KUJT I DREJTOHET ?

Fushata i drejtohet djemve dhe burrave, për t’u bërë ‘Modele Ndryshimi’ për komunitetin dhe shoqërinë. Figura të njohura i janë bashkuar Lëvizjes në nivel global si: Presidenti Barack Obama, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Ban Ki Moon, aktorë si Russell Crow, Mat Damon apo Emma Watson, e cila është përzgjedhur edhe si Ambasadorja e Vullnetit të Mirë për këtë fushatë.

Në Shqipëri mjaft figura të njohura nga kultura, politika, por edhe njerez të thjeshtë janë solidarizuar në këtë lëvizje për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave.

‘HEFORSHE NË STADIUM’

HeForShe në Stadium, është një iniciativë e UN Women në partneritet me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe me mbështetjen e Fondacionit Vodafone, duke u shtrirë në 10 ndeshje të superligës, në 9 qytete të Shqipërisë gjatë periudhës Tetor - Dhjetor.

“HeForShe në Stadium”, do të përfshijë informimin dhe ndërgjegjësimin e tifozëve brenda e jashtë stadiumeve të përzgjedhura.

APLIKACIONI “TIFOZI HEFORSHE”.

“Tifozi HeForShe” është një Aplikacion për telefona ‘Android’. E konceptuar si platformë komunikimi, argëtimi dhe ndërveprimi “Tifozi HeForShe” do të bashkojë të gjithë fansat e futbollit shqiptar duke: Luajtur e fituar çdo javë telefona të teknologjisë së fundit nga Vodafone, në Quiz-in “OFFLINE” dhe “LIVE”. Duke u argëtuar me lojën “Uniforma e Zemrës”. Duke u ndarë me miqtë dhe publikun e gjerë foto/mesazhe apo angazhimin tuaj në mbështetje të kësaj HeForShe.

**“HEFORSHE
NË STADIUM”:
NJË LËVIZJE
SOLIDARITETI
PËR BARAZI
GJINORE**



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT



UEFA
EURO2016
FRANCE

T



SHËRBIM, EKSPERIENCË, SHËNDET

Spitali Amerikan, Përqafoje jetën!



042 35 75 35 
www.spitaliamerikan.com  

NEWS

GRUMBULLOHET EKIPI KOMBËTAR U-19



Është grumbulluar ekipi kombëtar U-19, i cili do të marrë pjesë në eliminoret e Kampionatit Europian të kësaj kategorie. Siç dihet, ndeshjet do të luhen në Tiranë dhe Durrës, respektivisht stadiumet "Selman Stërmasi" dhe "Niko Dovana". Skuadrat që bëjnë pjesë në grupin eliminator janë Gjermania, Republika e Irlandës, Gjibraltari dhe Shqipëria. Ekipi kombëtar U-19, që drejtohet nga Arjan Bellai dhe Sulejman Demollari është grumbulluar në Durrës, ku ka nisur përgatitjet për tre ndeshjet që do të luhen më datë 6, 8 dhe 11 tetor. Ekipi është akomoduar në Resortin "Tropikal" në Durrës nga mbrëmja e djeshme. Sot ata kanë zhvilluar seancën e parë stërvitore. Për këtë grumbullim trajneri Arjan Bellai ka publikuar sot edhe listën e futbollistëve që do të ketë në dispozicion.

KOMBËTARJA U-15, GRUMBULLIM NË KAMËZ

Ekipi kombëtar U-15 do të grumbullohet nesër në Qendrën Stërvitore të Ekipeve Kombëtare në Kamëz, për një zbor dyditor. Trajneri Alessandro Recenti, ka grumbulluar rreth 35 futbollistë, të cilët janë seleksionuar nga grumbullimet e kryera në Greqi dhe Shqipëri. Kjo është hera e parë, që Shqipëria grumbullon një skuadër U-15 për tu përfaqësuar. Sipas shefit të sektorit të Ekipeve Kombëtare Denis Lilo, "Ky është një grumbullim, që ka për qëllim që të seleksionojë, lojtarët e evidentuar në grumbullimet e kryera në fillimi të vitit në Tiranë dhe Greqi. Ndërkohë, grupi do të plotësohet me futbollistë të tjerë, të cilët janë evidentuar nga stafi". Kjo është hera e parë, që Shqipëria U-15, do të grumbullojë skuadrën e saj kombëtare, të kësaj kategorie.



EURO U-19 FEMRA. HISTORIKE, SHQIPËRIA MPOSHT QIPRON

Shqipëria arriti fitoren e parë në fazën eliminator të Kampionatit Europian të futbollit për femra. Kjo është e para fitore zyrtare e kombetares U-19 në ndeshje zyrtare dhe për këtë arsye mund të konsiderohet historike. Pas dy humbjeve radhazi ndaj Skocisë dhe Serbisë që gjenden në të njëjtin grup, vajzat e teknikut Nevil Dede, kanë mposhtur në "Selman Stërmasi" përfaqësuesen e Qipros me rezultatin 2-0.

Ka qenë mesfushorja Koldashi e cila i ka dhënë fitoren e parë dhe me të rendeshmen në grup skuadrës me dygolëshin e saj në minutat 22' dhe 33' të ndeshjes. Shqipëria e mbylli e treta me tre pikë renditjen e grupit të katert, ku kreun e mban Serbia me 9 pikë, e ndjekur nga Skocia me 6 pike dhe Qipro që mbyll tabelën me 0 pikë. Kombëtarja U-19 e femrave, është krijuar vetëm katër vite më parë, ndërsa kjo, është hera e tretë që merr pjesë në një kompeticion ndërkombëtar futboll.



Kampionati kombëtar i Kategorisë Superiore, do të ketë edhe një risi krejtësisht të veçantë në edicionin e sivjetshëm. Sektori i Garave, në Federatën Shqiptare të Futbollit, ka menduar që gjatë ndeshjeve të këtij kampionati, të përdoren tabela të reja elektronike, për ndërrimet e futbollistëve dhe akordimin e minutave shtesë. Për herë të parë në Shqipëri, këto tabela do të jenë të unifikuara në pesë ndeshjet e Kategorisë Superiore. Tabelat elektronike, do të fillojnë të përdoren në ndeshjet e javës së tretë dhe në vazhdim. Sipas shefit të Sektorit të Garave, Lysien Nurishmi: "Tabelat do të jenë të personalizuara me logon e aktivitetit, pra me atë të Kategorisë Superiore". Kjo është një tjetër risi, e cila e synon që të krijojë një linjë të personalizuar për këtë aktivitet. Më herët Sektori i Garave, ka vendosur që në fanelat e futbollistëve që aktivizohen në këtë kampionat të vendoset logo e Kategorisë Superiore.

RISIA, TABELA ELEKTRONIKE TË UNIFIKUARA PËR K.S.



CEFERIN ZGJIDHET PRESIDENT I RI I UEFA-S

Aleksander Ceferin, është zgjedhur sot President i ri i UEFA-s. Presidenti i Federates Sllovene të Futbollit, ka fituar në zgjedhjet e organizuara në Kongresin e UEFA-s që po zhvillohet në Athinë. Kështu Ceferin, do të zëvendësojë në këtë detyrë ish-Presidentin Mishel Platini, i cili është pezulluar për një periudhë 5 vjeçare nga CAS i Lozanes. Menjëherë pas zgjedhjes së tij në krye të UEFA-s, ai është përshëndetur nga të pranishmit. “Ju uroj për detyrën e lartë, që ju besoj ky kongres dhe shpresoj që në drejtimin tuaj institucioni i futbollit evropian, të ece përpara drejt sukseseve të reja”-ka uruar Presidenti i Federates Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, që ka qenë i pranishëm në Kongresin e Athinës. Ai ka kryesuar delegacionin e FSHF, në cilin morrte pjesë Sekretari i Përgjithshëm Ilir Shulku dhe Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë Denis Bastari.



“UEFA B”, SEKTORI I EDUKIMIT VAZHDON KURSIN



Vazhdon në Qendrën Stërvitore të Ekipeve Kombëtare në Kamëz, kursi “UEFA B”. Në këtë kurs marrin pjesë trajnerët e grupmoshave dhe ata të futbollit amator. Kursi është organizuar nga Sektori i Edukimit, në Federatën Shqiptare të Futbollit, sipas një programi të ndërtuar që në fillimin e vitit. Ky është kursi “UEFA B”, numër 22. E veçanta e këtij kursi lidhet me faktin se pjesëmarrës në të është edhe ish-kapiteni i kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana, i cili po përgatitet që në të ardhmen të hyjë rrugës së trainingut. Ndërkohë, Sektori i Edukimit në Federatën Shqiptare të Futbollit, ka në proces kursin “UEFA PRO”, që vazhdon gjithë vitin. Ndërkohë do të organizohet kursi “UEFA A” për trajnerë portierësh dhe për drejtorë sportiv. Kursi “UEFA A” për trajnerë portierësh do të organizohet në pesë muaj me rradhë, javën e parë të çdo muaji. Ai organizohet për herë të parë në Shqipëri.

FSHF, NDERON KUJTIMIN E GRAMOZ PALUSHIT

Federata Shqiptare e Futbollit, ka respektuar kujtimin e Gramoz Palushit, djaloshit që humbi jetën mbrëmjen e 4 shtatorit të vitit 2004, pasi festonte me flamurin shqiptar fitoren e Shqipërisë, kundër Greqisë. I riu nga Kukësi, që kishte emigruar në Greqi, festoi rezultatin 2-1 që skuadra kuqezi arriti ndaj kombëtares së Greqisë, është goditur nga disa huliganë dhe më pas ka humbur jetën tragjikisht. Sot, 12 vjet më pas në sallën e bibliotekës së Muzeut Historik Kombëtar, shoqata “Gramoz Palushi” ka organizuar një aktivitet në nderim të tij. Ai është mbështetur nga Federata Shqiptare e Futbollit. Në të merrnin pjesë, intelektualë, përfaqësues shoqatash, familjarë dhe personalitete të fushave të ndryshme. I pranishëm ishte edhe anëtar i Komitetit Ekzekutiv të FSHF Abdyl Kuriu. Gjatë takimit kanë përshëndetur përfaqësues të shoqatave të ndryshme. Në emër të FSHF, Presidentit Armand Duka dhe ekipit kombëtar, ka përshëndetur përfaqësuesi i zyrës së shtypit Tritan Kokona. Në fund të fjalës së tij ai ka ftuar ish-kapitenin dhe ish –trajnerin e skuadrës përfaqësuese, Sulejman Demollarin për të dhuruar babait të Gramoz Palushit, bluzën e kom-



bëtares të Shqipërisë. Përfaqësuesi i organizatorëve Namik Selmani dhe babai i Gramoz Palushit, kanë falenderuar institucionin e futbollit shqiptar për vlerësimin dhe kontributin e tyre në këtë aktivitet.



PROMOCION: TIFOZËT E KOMBËTARES TAKOJNË IDHUJT KUQEZI

Në mesditë, tifoza të shumtë të Kombëtares kanë patur mundësinë të takojnë nga afër një grup lojtarësh të kombëtares në dyqanin zyrtar të Federatës Shqiptare të Futbollit I cili ndodhet në Rr. E Elbasanit (kryqezimi me Rr. Themistokli Gërmenji). Lojtarët Bekim Balaj, Migjen Basha, Andi Lila, Orges Shehi, Frederik Veseli dhe Naser Aliji kanë qenë sot të disponueshëm për të gjithë tifoza entuziastë ku ne rend të ditës ishin “selfie”-t dhe autografet e shumtë në foto dhe bluzat që shumë prej tyre i kishin veshur fizikisht. Njoftojmë të gjithë tifoza se zbritja prej 30% për bluzat e Kombëtares që FSHF kishte organizuar bashkë me promocionin e sotëm do të vazhdojë për gjithë ditën.

SIGURIMI I FUTBOLLISTËVE, KLUBET NJIHEN ME PËRFITIMET

Sot paradite në orën 10.00 në Federatën Shqiptare të Futbollit, Sektori i Garave dhe Sektori i Marketingut, organizuan një takim me përfaqësues të klubeve të Kategorisë Superiore dhe asaj të Kompanisë e Sigurimeve Sigal. Qëllimi i këtij takimi, ishte sqarimi i klubeve të futbollit në lidhje me përfitimet që do të kenë futbollistët në rast dëmtimesh, nga kompania "Sigal Uniqa Group Austria sh.s" që është edhe një prej sponsorëve të Federatës Shqiptare të Futbollit. Sipas kontratës së nënshkruar në muajin maj, nga Presidenti i FSHF Armand Duka dhe Drejtori Ekzekutiv i Kompanisë "Sigal Uniqa Group Austria sh.s" Avni Ponari, përfitues të sigurimeve do të jenë përveç lojtarëve të ekipeve kombëtare edhe futbollistët e Kategorisë Superiore. Në takim, ka marrë pjesë edhe anëtar i Komitetit Ekzekutiv të FSHF, Bardhyl Minxhozi. "Ishte një takim i karakterit informues, me klubet e Kategorisë Superiore, për ti njohur ata në lidhje me sigurimin që i bëhet futbollistëve të tyre, në raste të



dëmtimeve të mundshme gjatë edicionit futbollistik. Për çdo klub, kanë të drejtë të përfitojnë sigurime, 25 futbollistë"- deklaroi për faqen zyrtare të FSHF, shefi i Sektorit të Garave Lysjen Nurishmi.



MBLIDHET KOMITETI EKZEKUTIV I FSHF

Është mbledhur, Komiteti Ekzekutiv i Federatës Shqiptare të Futbollit. Nën drejtimin e Presidentit Armand Duka, institucioni vendimarrës në periudhën mes dy Asambleve, diskutoi për disa probleme dhe mori disa vendime të rëndësishme: Fillimisht është dëgjuar një raport për përfundimin e punimeve në stadiumin e Shkodrës, punime të cilat u inaguruan dje me ndeshjen miqësore Shqipëri-Marok. Më pas janë marrë këto vendime: Janë miratuar anëtarët e Komisioneve të Arbitrimin. Kryetar i Komisionit të Caktimit të Arbitrave është zgjedhur Petrit Brajha. Është miratuar formimi i strukturës së ekipit kombëtar U-15. Është miratuar lista e delegatëve për edicionin e ri futbollistik. Janë miratuar gjithashtu edhe disa ndryshime në Rregulloren e Futbollit Amator.

INAUGUROHET STADIUMI "LORO BORIÇI"

Stadiumi i rikonstruktuar "Loro Boriçi" është inauguruar zyrtarisht pak orë para nisjes së miqësore Shqipëri-Marok. Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë Presidenti i FSHF-së, Armand Duka, Kryeministri Edi Rama, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla, Kryebashkiakja e Shkodrës, Voltana Ademi, deputet të qarkut Shkodër, shumë figura të tjera politike dhe sportive, të cilët janë njohur me ambientet që ofron ky impiant modern. Të gjithë të pranishmit në këtë ceremoni inauguruese kanë vlerësuar punimet dhe kushtet që ofron impianti, që do të presë tani e tutje ndeshjet e Kombëtares Shqiptare dhe që ka një kapacitet rreth 16 mijë vende. Kryeministri Rama dhe Presidenti i FSHF-së, Duka, kanë shprehur përshtypjet e tyre pozitive për këtë investim të rëndësishëm për futbollin shqiptar dhe Kombëtares.



PREZANTOHET MJEKU I RI I EKIPIT KOMBËTAR

Gianluca Stesina, do të jetë mjeku i ri i ekipit kombëtar. Ai është prezantuar, gjatë konferencës për shtyp, që trajneri Gianni De Biasi zhvilloi me gazetarët. "Fillimisht dua të falenderoj dr. Arben Çelikun për punën dhe kontributin që ka dhënë në ekipin kombëtar. Do të mbetet gjithmonë një mik i mirë për ne. Ndërkohë që Gianluca me të cilin njihem që në kohën kur drejtoja Torinon, do të jetë mjeku ynë i ri"- theksoi gjatë prezantimit trajneri i kombëtares. Stesina ka qenë për 7 vjet mjeku sportiv i Torinos (2 vjet me skuadrën e parë dhe 5 vjet përgjegjës për skuadrën e parë). Ndërkohë që ka qenë për 4 vjet me Juventusin (përgjegjës për skuadrën e parë, fitues në tre kampionate dhe dy superkupa italiane). Aktualisht ai punon si drejtor sanitar i Juventus Medical Centre, pjesë një strukture mjekësore sportive, më e rëndësishmja në Itali për rehabilitimin e lojtarëve.

NJE APP (LIKACION) PER FUTBOLLIN SHQIPTAR

Ndërkohë, për publikun e gjerë futbolldashës, FSHF ka patur gjithmonë një vëmendje të veçantë kundrejt shërbimeve dhe kryesisht informimit në kohë reale mbi çfarë ndodh në futbollin shqiptar. Për sqarim theksojmë se kur themi “futbollin shqiptar”

NGA GAZMEND MALO

Me shpresën, madje me saktë me besimin e plotë që çdokush e din tashmë se çfarë është një app apo një aplikacion, besoj se titulli përshkruan dhe prezanton shumë qartë se për çfarë po flasim, duke qenë tashmë të gjithë familjarë me shërbimet e panumërta që ofrohen nëpërmjet telefonëve celularë sot (apo smartphone siç quhen ndryshe).


E pra, ky është çelësi që shpjegon edhe nismën tonë në këtë drejtim. Ky process nuk fillon nga hiçi dhe nuk është një krijim independent fryt i një ideje momentale, por vjen si pasojë dhe si pjesë e një plani më të gjerë që Federata Shqiptare e Futbollit kanë vënë në jetë në vitet e fundit me fokusin në planin digital.

Pas një lancimi të suksesshëm të dyqanit zyrtar të FSHF-së, I cili ofron tashmë prej disa vitesh produktet zyrtare të Kombëtares me dërgesa në adresën e shtëpisë për të gjithë tifozët kudo që ndodhen, ne pasuam natyrshëm me hapin tjetër I cili ishte platforma e shitjes online edhe të biletave dhe të abonimeve sezonale të ndeshjeve

të Kombëtares. Më tej lançuan edhe Klubin “Tifozët e Kombëtares” që nuk është një shërbim dixhital ne vevete, por që ofron një mori shërbimesh dixhitale siç është p.sh. e drejtë aksesi ne biletarinë online vetem për anëtarët e tij, blerje me zbritje me identifikim të anëtarit nëpërmjet kartës së tij të anëtarësisë në dyqanin e FSHF-së online, etj.

Ndërkohë, për publikun e gjerë futbolldashës, FSHF ka patur gjithmonë një vëmendje të veçantë kundrejt shërbimeve dhe kryesisht informimit në kohë reale mbi çfarë ndodh në futbollin shqiptar. Për sqarim theksojmë se kur themi “futbollin shqiptar” nuk kemi parasysh këtu Kategorinë Superiore dhe Kupën e Shqipërisë, të cilat transmetohen rregullisht nëpërmjet partnerit tonë mediatik Digitalb dhe TVSH gjithashtu, por për të gjithë futbollin shqiptar dhe që përfshijnë Kategorinë e pare, Kategorinë e Dytë si dhe ndeshjet e “ekipeve zinxhir” ose “të moshave” sic njihen ndryshe.

Nën këtë ndikim dhe duke parë zhvillimet e fundit te-





knologjike, na u duk e udhës të ndërtonim një aplikacion për telefon celular, me suportin e agjencise partnere për shërbime web New Media, i cili të ofrojë informacion konstant në një aparat që sot gjithkush e ka me vete në çdo moment.

Qëllimi i këtij aplikacioni pra është informimi, por në mënyrë aktive, që do të thotë të “tringëllon” në dorë apo në xhep kur skuadra jote e zëmërës shënon një gol, kur një lojtar merr një karton të kuq, apo edhe thjesht kur fillon dhe kur mbaron ndeshja.

Por të flasësh për një aplikacion në një artikull reviste nuk është shumë e thjeshtë dhe ndoshta pak e mër-zitshme por ju siguroj ose më mirë, ju garantoj që është shumë më e lehtë dhe argëtuese ta provoni vetë duke e përdorur atë nëpërmjet disa hapave shumë të thjeshtë:

- Së pari ky aplikacion është zyrtar i FSHF-se, i autorizuar dhe i disponueshëm në platformën “Google Play” për android dhe në app store për përdoruesit e ios (iphone)

- Është i identifikueshëm shumë lehtë nëpërmjet ikonës kuqezi me logon e FSHF-së

- Ka një menu të thjeshtë dhe intuitive ku ti mund edhe thjesht të informohesh në seksionet “tradicionale” me news dhe foto të ndryshme

- Në seksionin “notifications” mund të aktivizosh të gjithë eventet për të cilët dëshiron të njoftohesh në kohë reale mbi rezultatin dhe informacionet e tjera kryesore si psh. golat, penalltë, kartonat e mundshëm, fillimin dhe mbarimin e lojës, etj

Nëse keni ndjekur hapat më lart dhe keni aktivizuar “notifikimet” për skuadrën apo eventin e dëshiruar, kjo ju bën tashmë një prej shumë përdoruesve “zyrtarë” të këtij aplikacioni.

Me besimin që do ta shijoni dhe do t’ju pëlqejë, ju kërkujmë gjithashtu që të na njoftoni nëpërmjet linkut “kontakt” për çdo ide apo sugjerim për si ta përmirësojmë këtë aplikacion dhe experiencën e përdoruesve të tjerë ;)



PËRZGJEDHJA E TALENTEVE

Ja si projektohet e ardhmja



Ja sa futbollistë janë vëzhguar:

SELANIK	dt. 1998-99 (31 kandidatë)	dt.2000-01 (36 kandidatë)
ATHINË	dt.1998-99 (85 kandidatë)	dt.2000-01 (75 kandidatë)
ZYRIH	dt.1998-99 (36 kandidatë)	dt.2000-01 (23 kandidatë)
VERONA	dt.1998-99 (55 kandidatë)	dt.2000-01 (50 kandidatë)
TIRANËS - DURRËS	dt.1998-99 (155 kandidatë)	dt 2000-01
FIER - KORÇË	dt.1998-99 (60 kandidatë)	dt 2000-01
SHKODËR -ELBASAN	dt.1998-99 (50 kandidatë)	dt.2000-01
KOSOVA	dt.1998-99 (40 kandidatë)	dt.2000-01

U-17 dhe specialistët më të mirë të FSHF, përgjatë edicionit zhvillojnë disa seleksionime. I pari, me futbollistë kandidatë që aktivizohen jashtë Shqipërisë dhe i dyti me lojtarë që aktivizohen në Shqipëri dhe Kosovë. Ndërkohë një tjetër grup pune ndjek nga afër edhe futbollistë të talentuar që luajnë në vende të tjera dhe kanë tërhequr vëmendjen e specialistëve dhe mediave të huaja. Duke qenë se qëllimi kryesor i ekipeve të moshave është furnizimi me futbollistë të talentuar i skuadrës kombëtare, mendoj se është bërë dhe po bëhet një punë e mirë në këtë drejtim. Edhe në ekipin aktual shpresa janë disa futbollistë që janë përfshirë në planet afatgjata të trajnerit de Biazi dhe stafit të tij. Seleksionimet kanë nisur me e futbollistë kandidatë për ekipet kombëtare të moshave, që aktivizohen në Greqi. Një grup specialistësh nga Federata Shqiptare e Futbollit, për katër ditë me rradhë kanë vëzhguar në Selanik dhe Athinë, lojtarë shqiptarë që jetojnë në Greqi. Nën vëzhgimin e Redi Jupit trajner i ekipit kombëtar U-21, Arjan Bellait trajner i ekipit kombëtar U-19, Xhemal Mustedanagiq trajner i ekipit kombëtar U-17 dhe specialistit të futbollit Abdyl Kuriu, anëtar i Komitetit Ekzekutiv të FSHF, kanë performuar rreth 230 kandidatë. Në ditën e parë, seleksionimet janë zhvilluar në Selanik dhe për të dyja datëlindjet 1998-99 dhe 2000-2001, me pjesëmarrjen e rreth 70 futbollistëve. Më pas janë organizuar në Athinë. Në ditën e parë dhe të dytë, janë seleksionuar rreth 160 futbollistë të tjerë. Për grupmoshat 1998-1999 kanë qenë 85 futbollistë. Ndërsa për grupmoshat 2000-2001 kanë performuar 75 lojtarë kandidatë. Në ditën e tretë dhe të fundit, seleksionimi është kryer me rreth 50 lojtarë, të përzgjedhur nga dy ditët e para. Për grupmoshën 1998-1999 janë përzgjedhur 25 futbollistë, ndërsa për grupmoshën 2000-2001 kanë qenë rreth 26 lojtarë. Në qytetin e Veronës, u zhvillua seleksionimi me futbollistë nga ky Italia ndërsa në Zyrin me futbollistë nga Zvicra dhe Gjermania. Në Zyrin, morën pjesë për datëlindjen 1998 – 1999, 36 kandidatë, ndësa për datëlindjen 2000-2001 morën pjesë 23 kandidatë. Ata u ndoqën nga zv/trajneri i kombëtares Paolo Tramezzani, trajneri i ekipit U-21 Redi Jupi, trajneri i ekipit U-19 Arjan Bellai, trajneri i ekipit U-17 Xhemal Mustedanagiq dhe specialisti i futbollit Abdyl Kuriu anëtar i Komitetit Ekzekutiv të FSHF. Në Verona, kanë marrë pjesë 55 futbollistë kandidatë të ekipit kombëtar të datëlindjes 1998-1999. Ndërkohë që për datëlindjen 2000-2001 ishin gjithsej 57 lojtarë. Në Itali, seleksionet u ndoqën nga dy ndihmësat e trajnerit të ekipit kombëtar Tramezzani dhe Bogdani. Sipas një grafiku të përcaktuar më parë është kryer edhe seleksionimi me futbollistë kandidatë të ekipeve kombëtare, nga të gjitha zonat e Shqipërisë edhe nga Kosova. Gjithsej janë seleksionuar 305 të datëlindjes 1998-1999. Më pas janë seleksionuar edhe futbollistë të datëlindjes 2000-2001.

Federata shqiptare e Futbollit, e ka si një prioritet të sajin përzgjedhjen dhe mbështetjen e talenteve të futbollit shqiptar. Duke parë nga e ardhmja dhe duke e vlerësuar evidentimin e përzgjedhjen e futbollistëve të talentuar, FSHF po punon prej kohësh në bazën e një strategjie të ndërtuar me kujdes.


Prej shumë vitesh po bëhet një punë e kualifikuar dhe profesionale, që nis me seleksionimin dhe vazhdon me ndjekjen dhe mbështetjen e këtyre futbollistëve që premtojnë në të ardhmen. Drejtoria e Ekipeve Kombëtare, tashmë ka evidenca të plota dhe të dhëna për shumë lojtarë që luajnë jashtë Shqipërisë dhe për të tjerë që luajnë në Shqipëri dhe Kosovë. Duke qenë se qëllimi kryesor i ekipeve të moshave është furnizimi me futbollistë të talentuar i skuadrës kombëtare, është bërë dhe po bëhet një punë e mirë në këtë drejtim. Edhe në ekipin aktual shpresa janë evidentuar disa futbollistë, që janë përfshirë në planet afatgjata të trajnerit de Biazi dhe stafit të tij. Prej disa vitesh, organizohen seleksionime me kandidatë të skuadrave kombëtare për moshën të ndryshme. Trajnerët e skuadrave kombëtare, U-21, U-19,

Is this a
DREAM ?

Explore with
Vas Dream.

member 
VAS GROUP

- Online Platform
- Mobile Application



vasdream.com


vasdream

Më pranë Kombëtares me kartën Kuq e Zi



UNIONBANK
Banka që dua

Union Bank, sponsor krenar i kombëtares Kuq e Zi, në bashkëpunim me FSHF mundëson kartën e re të kreditit MasterCard, të personalizuar me notat e kombëtares dhe shoqëruar me plot surpriza të tjera:

- Antarësim automatik në klubin “Tifozët e Kombëtares” pa asnjë pagesë shtesë
- Bileta të garantuara për ndeshjet zyrtare dhe miqësore të kombëtares për ndeshjet kualifikuese të Botërorit 2018
- Zbritje deri në 10% për blerjet në dyqanin e FSHF dhe pikat e tjera të autorizuara prej saj
- 0% komision për të gjitha blerjet brenda apo jashtë vendit

Aplikoni online tek www.unionbank.al/karta apo ne www.fshf.org

☎ 0800 0800

SHQIPËRI - SPANJË

HISTORIA NË PESË PËRBALLJE



Shkëlqim Muça, autori i golit në
ndeshjen Shqipëri-Spanjë të vitit 1986
gjatë një dyluftimi



Historia e përbaljes Shqipëri-Spanjë, e ka fillimin në fund të viteve 80-90-të me takimet e paharruara Flamurtari-Barcelona, për Kupat e Europës

NGA UVIL ZAJMI

Historia e përbaljes Shqipëri-Spanjë, e ka fillimin në fund të viteve 80-90-të me takimet e paharruara Flamurtari-Barcelona, për Kupat e Europës me klube kur për herë të parë në një stadium shqiptar luante një klub spanjoll, madje nga më të njohurit, Barcelona. Si asnjëherë në të kaluarën shorti nuk e kishte përballur përfaqësuesen, apo një skuadër me futbollin iberik. Dhe rezultatet ishin më shumë se surprizë: Barazime spektakolare në 1-1 në Vlorë e 0-0 Camp Nou dhe katalanasit që kualifikohen. Sërish një përballje tjetër, pas një vit Flamurtari-Barcelona, që i hapin rrugë e për të ardhur tek sfidat e shumëpritura midis ekipeve përfaqësuese. Nga ato ndeshje na ndajnë shumë vite, por kujtesa na rikthen menjëherë pasi kanë qenë dhe mbeten unikalë, ndonëse fitoret e spanjolleve kanë qenë të padiskutueshme madje të thella, por që në start kanë protagonistë futbollistët shqiptarë. Nga goli i Shkëlqim Mucës realizuar pas një kombinimi me Arben Migën në minutën e 28-të takimit të parë historik të luajtur në “Qemal Stafa” në dhjetorin e 86-tës për Eliminatoret e Kampionitit European, ishte ai që i shtangu dhe për më shumë se një pjesë lojës krijoi panik tek kundërshtarët që kishin në përbërje lojtarë të njohur titullarë të Realit, Barcelonës e që me vështirësi kanë barazuar, kanë humbur edhe një penallti të pritur nga Musta deri në momentin që realizuan golin e fitores minimale. Pastaj ndeshja e fundit dhe goli fenomenal i Sokol Kushtës, një takim ky për Eliminatoret e Botërorit 94, në Tiranë më 22 shtatorin e vitit 1993, ndonëse në këtë takim fitorja ishte më e lehtë për skuadrën spanjollë.

Asnjëherë më parë nuk kemi një përballje, por nga ai dhjetëv-jecar merr rrugë historia e sfidave Shqipëri-Spanjë, ndonëse e filluar me vonesë në kohë e me pak takime të zhvilluara ajo është me mjaft ngjarje, ka si protagonistë futbollistë të elitës, por edhe shumë gola të shënuar. Kjo përballje ka sjellë në Tiranë nga trajneri Munoz e Klemente, portjerin Zubizare-

macron

**SPONSOR TEKNIK
I FEDERATES SHQIPTARE TE FUTBOLLIT**

ta, Kamacion, Mitcell, Butragenjon, Nadal, Hierro, Salinas, Goikoecea. Në ndeshjen e 22 shtatorit të vitit 1993 fituar nga Spanja me rezultatin 1-5, në fushën e Qemal Stafës, ka luajtur edhe Pep Guardiola, trajneri i famshëm i Barcelonës, Bajernit dhe Manchester Citit në Premier League, i cili është futur në lojë në minutën e 51 duke zëvendësuar Guerreron. Por, ai që ka një rekord absolut është Zubizareta, që si asnjë futbollist tjetër si nga Shqipëria e Spanja i ka luajtur të gjithë sfidat ndërmjet dy skuadrave, duke përfshirë edhe ato si titullar në katër ndeshjet me klube midis Flamurtarit e Barcelonës. Kjo përballje na rikthen gjithashtu edhe tek trajnerë e futbollistë shqiptarë që i kanë dhënë emocion, këtyre sfidave. Nga i paharruar Agron Sulaj që ndaj Spanjës e drejtoi kombëtaren kur ishte 32-vjeç duke regjistruar kështu trajnerin më të ri në historinë e teknikëve që janë ulur në stolin e përfaqësueses shqiptare. Agron Sulaj u përball dy herë me Spanjën pa mundur të marrë asnjë pikë, për të vijuar me një tjetër trajner të shquar si Bejkush Birçen që edhe ky e drejtoi kombëtaren ndaj Spanjës në dy ndeshjet e tjera disa vite më vonë, por edhe ky pa mundur të marrë asnjë rezultata pozitiv, ndaj një skuadre shumë të fortë në përbërje me kampionë dhe traditë të madhe në historinë e futbollit botëror.

Dhe këtyre takimeve i bashkohet një listë e gjatë me futbollistë protagonistë nga kjo kombëtare, duke filluar nga portjerët Musta, Lekbello, Arapi e Strakosha, me mbrojtësit R. Vata, Abazi, Zmijani, Ibro, Dema, Stafa, Taho, Ocelli, Gega, Hodja, Iljadhi, Omuri, Shulku, A. Lekbello, Zijai, mesfushorët B. Kola, Tahiri, Shehu, Gjondeda, Millo, Ferko, Demollari, Josa, dhe sulmuesit Kacaj, A. Kola, Kepa Fortuzi, Kushta, Abazi, Barbul-lushi, Bubeqi, Jera, Minga dhe Muça.

Numra pikantë:

Në pesë përballjet kombëtarja shqiptare ka mundur të realizojë vetëm dy gola dhe autorët e tyre janë, Muça e Kushta.

Spanja ka shënuar 24 gola në portën e Shqipërisë, e cila është mbrojtur nga katër portierë të ndryshëm, Musta, Arapi, Lekbello e Strakosha dhe ky i fundit, është i vetmi portier, që ka zhvilluar dy ndeshje kundër kombëtares spanjolle.

Njëmbëdhjetë janë futbollistët spanjollë që kanë shënuar në portën shqiptare dhe shifra tregojnë se nga katër gola kanë realizuar Bakero e Butragenjo (ky i fundit në një ndeshje të vetme, atë zhvilluar në Sevillje me 19.12.1990). Tre janë futbollistët që kanë shënuar nga 3 gola, Salinas (edhe ky në një takim të vetëm), Mitçell e Munioz. Në këtë listë është edhe mbrojtësi Hiero që ka shënuar dy herë në portën shqiptare. Ndërsa pesë futbollistë kanë shënuar nga një gol. Ata janë Arceche, Joaquin, Lorente, Amor, Kaminero.

Tre janë janë penalltitë e dhëna mes Shqipërisë e Spanjës e të treja të fituara nga ana e skuadrës spanjolle, pikërisht në ndeshjen e parë, të dytë e të katërt. Interesant është fakti, se e para është akorduar në Ti-



ranë dhe gjuajtjen e Cendos e ka pritur Musta, ndërsa dy të tjerat janë realizuar nga i njëjti futbollist Mitçell të dhëna në ndeshjet e zhvilluara në Spanjë.

Në pesë përballjet mes Shqipërisë e Spanjës, dy prej tyre janë drejtuar nga arbitra zviceranë. Janë pikërisht Rotshlisberger në takimin e dytë atë të 3 dhjetorit zhvilluar në Tiranë (1-2) dhe Mubnesaler në ndeshjen e katërt, në Sevillje më 22 prill 1992 (0-3). Arbitrat e tjerë të këtyre përballjeve kanë qenë Hutak (Hungari), Kostandin (Belgjikë) e Harrell (Francë).

Në tre takimet e luajtura në Spanjë, ato janë zhvilluar në Sevillje, dhe jo në Madrid, Barcelonë apo qytet tjetër.

Nga pesë sfidat që janë zhvilluar të gjitha i përka-sin fazave Eliminatoret të Kampionatit European, 1986-1988 Grupi I, ku bashkë me Shqipërinë ishin edhe Spanja, Rumania e Asutria, ndërsa për sezonin 1990-1992 sërish në grupin e parë Shqipëria do të kishite si rivalë, Francën, Çekosllovakinë, Spanjën dhe Islandën. Vetëm një herë, për Eliminatoret e Kampionatit Botëror 1992-1992 tashmë në grupin e tretë, Shqipërisë i ka takuar të jetë në grup me Spanjën, Irlandën Danimarkën, I. Veriut Lituani dhe Letoninë. Në total, bilanci midis Shqipërisë e Spanjës, është: 5 ndeshje 5 humbje 0 barazime 0 fitore golavezhi 2-24.

Kombëtarja e Shqipërisë dhe e Spanjës përpara ndeshjes së vitit 1993



ARBITRAT SHQIPTARË NË KUPAT E EUROPËS

Jorgji dhe Jemini marrin vlerësime të larta në ndeshjet që drejtuan në Uefa Champions League dhe Uefa Europa League

Arbitrat shqiptarë të FIFA-s, u bënë protagonistë në ndeshjet e tureve të para eliminatorë të trofeve europianë, Champions League dhe UEFA Europa League. Pikërisht Enea Jorgji dhe Lorenc Jemini, u caktuan nga UEFA në drejtimin e ndeshjeve, dhe u shndërruan në protagonistë në ndeshjet e tureve eliminatorë të trofeve kontinentale, për sezonin 2016-2017.

I pari që ka udhëtuar për të drejtuar ndeshjen e turit të parë në UEFA Champions League, ka qenë ndërkombëtar i Lorenc Jemini bashkë me asistentët Denis Rexha, Ilir Tartari (FIFA) dhe Kridens Meta, në rolin e arbitrit të katërt. Bilbilit shqiptar i është besuar sfida në Republikën e San Marino, midis ekipeve “SP Tre Pene” dhe “New Saintis FC” të Uellsit. Për Jeminin kjo ishte hera e dytë që e rikthen atë në shtetin e vogël të San Marinos, kur sezoni më parë ka drejtuar një sfidë tjetër të UEFA Europa League. Në “San Marino Stadium”, më i madhi në Republikën e San Marinos, takimi është mbyllur me rezultatin 0-3 për uellsianët. Ishte një përballje pa probleme, ndonëse Jemini ka ndëshkuar



Enea Jorgji dhe Lorenc Jemini, dy gjyqtaret e Uefës që kanë marrë vlerësime të larta në ndeshjet që drejtuan në Uefa Champions League dhe Uefa Europa League

me pesë kartona të verdhë dy futbollistë vendas e tre të skuadrës udhëtuese. Vëzhguesi i ndeshjes ka qenë kroati Dragutin Poljak, ish-arbitër i njohur i FIFA-s, i cili e ka vlerësuar me notën e lartë 8.3 arbitrimin e Lorenc Jeminit. Në karrierën e tij dhjetë vjeçare si arbitër i FIFA-s, kjo ishte ndeshja e 33-të e Jeminit në kompeticionet ndërkombëtare.

Ndërkombëtarit tjetër, Enea Jorgji UEFA i ka besuar dy sfida edhe këto në raundet eliminatorë të kompeticioneve europiane. Në takimin e parë, për UEFA Europa League, bashkë me asistentët Ermal Barushi e Rejdi Avdo dhe arbitrin Klajdi Kola, treshja shqiptare ka gjykuar takimin-vajtje midis "Videoton"- "Zaria Balti FC" (Moldavi), zhvilluar në stadiumin "Pancho Aréna" të qytetit Felcsút në Hungari. Ajo ka përfunduar me rezultatin 3-0 për vendasit, një takim gjatë të cilit Jorgji ka akorduar pesë kartona të verdhë dhe një të kuq (3 + 1 karton të kuq për udhëtuesit dhe 2 të tillë për vendasit). Edhe vlerësimi teknik i vëzhguesit nga Polonia Tomazs Mikulski ka qenë i lartë, duke e dhënë notën 8.3 Jorgjit. Sfida e dytë për arbitrin shqiptar,

ka qenë ajo në UEFA Champions League, luajtur në Austri. Bashkë me asistentët Egin Doda, Denis Rexha (FIFA) nga kolegji i Tiranës dhe Andi Koçi si arbitër i katërt nga kolegji i arbitrave të Durrësit, ata kanë drejtuar ndeshjen e zhvilluar në "Stadion Salzburg"- të Salsburgut midis skuadrës vendase "FC Salzburg" dhe "FK Liepaja"(Letoni). Në prani të 6 mijë spektatorëve ekipi vendas ka fituar 1-0 me gol shënuar në fundlojë, ndërsa Jorgji ka ndëshkuar me dy kartona të verdhë futbollistët e skuadrës letoneze. Vëzhguesi i takimit Kaj Natri nga Finlanda e ka vlerësuar pozitivisht me notën 8.3 drejtimin e ndeshjes nga arbitri Enea Jorgji. Për Jorgjin e FIFA-s, ky ka qenë takimi i 30-të i tij në turnetë e ndryshme europiane nga të cilat spikat pjesmarria e tij në finale të europianit të 19-vjeçarve, duke u caktuar si arbitër i katërt në finale të tij, duke regjistruar edhe rastin e parë për një arbitër shqiptar në një aktivitet kaq të rëndësishëm ndërkombëtar. Gjithashtu vlen të përmendet edhe takimi miqësor midis skuadrave Maqedoni-Bullgari i drejtuar prej tij.



NDRYSHON RREGULLORJA:

JQ KARTON I KUQ PËR LOJTARIN E FUNDIT



Nga 1 qershori
IFAB vendos nen
të ri dhe orineton
për tjetër aplikim të
Kapitullit të 12-të

Shumë i polemizuar nga të gjithë klubet, federatat, trajnerët, specialistët e futbollistët, më në fund IFAB ka vendosur të ndryshojë nenin e Kapitullit të 12-të Rregullores së Lojës, ku flitet për “ndëshkimin me karton të kuq të futbollistit i konsideruar i fundit, në rastet kur shkakton faull ndaj kundërshtarit duke i hequr mundësinë atij për të shënuar”. Nisur nga 1 qershori, bashkë me disa ndryshime të tjera në Rregulloren e Lojës Futbollit, ai më kryesori është se urdhëron duke i orientuar arbitrat në një tjetër interpretim të rasteve kur ata e konsiderojnë faull ndërhyrjen e një futbollistit i konsideruar i fundit, që përfshihen në Kapitullin e 12 të Rregullores, në rastet e ku trajtohen “Ndërhyrjet korrekte dhe jo korrekte dhe ndëshkimi i tyre”. Gjithçka është vënë në funksionim dhe ky aplikim i ri, ka filluar të zbatohet në të gjitha aktivitetet ndërkombëtare, dhe ato kombëtare të çdo vendi anëtare të FIFA-s. I vendosur vite me parë, ky nen i rregullores mjaft diskutuar sepse përfshihej ndëshkimi dyfishtë, pra ai teknik me 11-metërsh brenda zonës së 16-të metrave dhe ai disiplinor me karton të kuq, nuk do të funksionojë më. Ka qenë këmbëngulja e klubeve, që e kanë detyruar IFAB-in, të marrë në shqyrtim dhe të ndryshojë këtë nen të vendosur nga vetë ky komision. Sipas udhëzimit të ri, IFAB informon se ky rast do të ketë këtë interpretim:

Kur një lojtar kryen një shkelje (faull) kundër një kundërshtari brenda zonës së penalltisë, i cili i mohon një kundërshtari një mundësi të qartë shënimi goli dhe arbitri jep penallti, lojtari fajtor paralajmërohet me karton të verdhë nëse:

Shkelja është një mbajtje, tërheqje apo shtyrje

Lojtari fajtor nuk përpiqet të luajë me topin, ose nuk ka mundësi të bëjë ndërhyrje për topin Ndërsa për “Faullat serioze e sjelljet violente”, IFAB nuk ka ndryshuar asnjë sanksion dhe udhëzon:

Shkelja është e ndëshkueshme me karton të kuq kudo ku ndodh në fushën e lojes duke përfshirë edhe zonën e penalltisë.

Një ndryshim tjetër është bërë edhe në ekzekutimin e penalltisë ku me orientimet e reja është shtuar masa disiplinore për portierin fajtor.

MË POSHTË ËSHTË TABELA KU EVIDENTOHET NDRYSHIMI:

FUTJE NË ZONË NGA LOJTARI SULMUES	Penaltia rigjuhet	Goditje indirekte
FUTJE NË ZONË NGA LOJTARI MBROJTËS	Gol	Penalltia rigjuhet
SHKELJE NGA ANA PORTIERIT	Gol	Penalltia rigjuhet dhe kv për portierin
TOPI I GODITUR MBRAPA	God.indirekte	God.indirekte
LËVIZJA MASHTRUESE	God.indirekte dhe KV për lojtarin që godet	God.indirekte dhe KV për lojtarin qëe godet
GODITJA BËHET JO NGA LOJTARI I IDENTIFIKUAR	God.indirekte dhe KV për lojtarin fajtor (të pa identifikuar)	God.indirekte dhe KV për lojtarin fajtor (të pa identifikuar)



PICCOLI CAPRICCI

ama[®]

C A P S U L E

Tel. +355 44 517 002 info@amacaffe.al www.amacaffe.com